REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 849/20
Datë/Datum. 23.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

Sa i përket tenderit për: Furnizim emergjent me teste serologjike per SARS-COVID-19

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	**616-20-5738-1-1-1**
Nr i brendshëm	**616 20 136 111**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

UNI-CARE SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Sylejman Vuqiterrna, Nr.1, Hyrja-51

(Adresa)

Prishtinë — *10 000*

(Vendi) — *(Kodi postar)*

+38345601502 — *N/A*

(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Ismajl Shurdhaj

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

unicare.ks@gmail.com

(Adresa elektronike)

23.10.2020

(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Njoftimi për kontrate është publikuar me date 25.09.2020
Afati për Dorëzim te ofertës ka qenë deri me 30.10.2020
Kërkesa për informacion Shtese është dërguar me datën: 29.09.2020
Njoftimi për sqarime shtesë nga AK për OE ka qenë: me datën: 06.10.2020
Kërkesa për rishqyrtim është dërguar tek AK me datën: 09.10.2020
Njoftimi mbi vendimin e AK-së dt. 13.10.2020
Vendimi i AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim dt. 13.10.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☒

Procesi i hapjes së tenderit ka qenë në rregull dhe pa ndonjë vërejtje.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] Jo ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 28 i LPP-së

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar,

AK ka publikuar njoftimin për kontrate me titull "Furnizim emergjent me teste serologjike për SARS-COVID-19" ku si për qellim kane furnizimin me teste serologjike për detektimin e virusit SARS-COVID19.

Ne njoftimi për kontratë AK ka specifikuar teste serologjike të vetëm një prodhuesi gjë që pamundëson ofertimin apo pjesëmarrjen e OE-ve të tjerë në këtë aktivitet të prokurimit të cilët gëzojnë të drejtën e reprezentimit të prodhuesve të tjerë.

Me datën 29.09.2020, ne kemi dorëzuar tek AK kërkesën për informacion shtesë duke kërkuar që të na lejohet ofertomi i testeve nga prodhues të tjerë duke ofruar që së bashku me testet të dorëzohet në formë donacioni edhe aparatura me performancë dhe kapacitet më të lartë se ajo ekzistuese, e cila do të mundësoj realizimin e testeve.

Me datën 06.10.2020, AK njofton me sqarime shtesë duke refuzuar kërkesën tonë për lejimin me test serologjike ku së bashku me testet do të dorëzohej në formë donacioni edhe pajisja për realizimin e testeve me arsyetimin së kanë aparatura në shfrytëzim nga një OE tjetër (jo pronë e komunës apo QKMF-ve) dhe se nuk mund të pranojnë një pajisje tjetër shtesë e cila do të bëhet pronë e Komunës, gjithashtu AK ka propozuar të kontaktojmë me kabinetin e kryetarit për dhënien e donacionit dhe sqarimin e përparësive të specifikave të pajisjes sonë. Propozimi i AK për ne është i palogjikshëm pasi që kërkesën tonë departamenti i Prokurimit mund të përcjell tek kabineti i kryetarit të AK-së për shqyrtim dhe lejim. Mos veprimi i tillë është kundër interesit të AK-së dhe qytetareve të komunës së Prishtinës të cilët do të përfitonin nga ky donacion.

Me datën 09.10.2020, ne OE pas analizimit me kujdes të përgjigjes së pranuar nga AK kemi bërë kërkesën për rishqyrtim të specifikave duke konstatuar se AK ka dhënë përgjigje të njëanshme e cila është në kundërshtim me ligjin e prokurimit dhe me qëllim të favorizimit të një OE të vetëm. Ne kërkesën për rishqyrtim drejtuar AK-së ne kemi kërkuar ndryshimin e specifikave më të njëjtin arsyetimin sikurse në kërkesën për informacion shtesë të datës 29.09.2020.

Me datën 13.10.2020, AK me vendimin e saj ndaj kërkesës sonë për ri-shqyrtim të dërguar me datën 09.10.2020 refuzon si të pabazuar kërkesën duke u arsyetuar përsëri me propozimin për kontaktimin me zyrën e kabinetit të kryetari për prezantimin e kërkesë sonë për donacionin e pajisjes.

Ne mendojmë qe propozimi i AK-së për kontaktim me zyrën e kabinetit të kryetarit dhe refuzimet ndaj kërkesave tona si OE kanë përcëllimë devijimin dhe shmangien e kërkesës sonë ndaj zyrës së prokurimit dhe realizimin e procedurës së prokurimit me pretendimin e realizimit të interesave vetanake të OE-ve të cilat kanë pasur për qëllim keqpërdorimin e buxhetit me paramendimin e dhënies në shfrytëzim të aparaturave duke i kushtëzuar ata për furnizim produktet konsumuese (teste) vetëm nga ata, ky veprim kushtëzon AK-në në aspektin financiar duke ngritur koston e produkteve shpenzuese në këtë rast testeve në një çmim dukshëm më të lart se sa vlera mesatare e testit në tregun e lirë.

Ne si OE kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit të shqyrtoj me kujdes kërkesën tonë duke marr vendimin e lejimit të kërkesës sonë si më poshtë:

Ne si OE kërkojmë të na lejohet që në kuadër të çmimi të testeve të ofertojmë një aparaturë falas dhe me performancë më të mirë se aparatura ekzistuese e cila është në gjendje të realizojë deri në 2,400 teste brenda 24 orëve, testet të cilat do të ofertohen kanë sensitivitetin 100% dhe specificitetin – 99.6%, kjo do të thotë se në 100 mostra të marrura gabimi maksimal mund të jetë 0.4% apo një mostër, gjë që nuk mund të përmbushet nga pjesa më e madhe e prodhueseve të tjerë, kjo është në dobi të Autoritet Kontraktues, QKMF-

së dhe qytetarëve të komunës së Prishtinës pasi që brenda disa ditëve ka mundësi të realizohet një numër i madh i testeve dhe me saktësi maksimale, kjo qasje krijon barazi apo konkurrence të mirëfilltë, gjithashtu është praktikë edhe vendeve tjera për procedura me teste serologjike,

Gjithashtu neni 18.9 i RRUOPP-së përcakton qartë "*Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk:*
☐ *Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose*
☐ *Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë EO-ve.*

Me këto specifikime që AK i ka bërë nuk ofrohet qasje e barabartë për të gjithë ofertuesit.

Veprimet e AK-së me këto specifika janë në kundërshtim edhe me nenin 7. Paragrafi 6 të LPP-së ku Shkruan: *Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; **(i)** pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; **(iii)** eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik*:

Po ashtu me kërkesat e lartpërmendura mund të mos përmbushet qëllimi i këtij aktiviteti të prokurimit, ndërsa veprimet e autoritetit kontraktues mund të bien ndesh edhe me qëllimin e LPP-së, ku në nenin 1 të këtij ligji parashihet qartë që "*Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë*".

Nëse veprohet më tutje me këto specifikime dhe në këtë mënyrë, autoriteti kontraktues rrezikon seriozisht të dëmtojë buxhetin sepse në momentin kur kufizohet konkurrenca për prodhues të caktuar, atëherë mundësia është shumë e madhe që të ofrohen çmime shumë më të larta, se sa vlera e tregut, prandaj edhe rrezikohet të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të LPP-së dhe natyrisht cenohet edhe neni 6 i LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale akoma nuk i kemi llogaritur sepse jemi në fazën e njoftimit për kontratë

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*